



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail. contact@pallatirinise.com

www. pallatirinise.com

Nr. 1/1615 Dt. 17.07.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 5, pikës 5.2, nenit 16, pikës 16.2 të Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 6 të Ligjit nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të Statutit të NPL Pallati i Rinisë sh.a., Komisioni Komunal i Aksionarëve me datë 17.07.2026 merr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET Vendimi për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e 4 (katër) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për NPL Pallati i Rinisë sh.a.

II. Konkursi publikohet së paku në 1 (një) gazetë të përditshme në Republikën e Kosovës si dhe në faqen zyrtare të NPL Pallati i Rinisë sh.a. në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën serbe.

III. Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë nga datë 17.07.2026 deri më 15.08.2026.

IV. Konkursi duhet të përmbajë kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike.

V. Zgjedhja e 4 (katër) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për NPL Pallati i Rinisë sh.a, bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve me procedurë të përzgjedhjes përmes konkursit publik, për mandatin prej 3 (tre) viteve.

T'i dorëzohet:

- Një nga gazetatat e përditshme informative;
- Të publikohet në web faqe të Ndërmarrjes;
- Arkivë.

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE:

Mimoza Sylejmani, 

Arian Shabanaj, 

Sabri Dragusha, 

